



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

KRYETARI

Nr. 722/e Prot.

Shkodër, më 23/12/2024

Vendim


Nr. 31, Datë 20/12/2024

“Mbi miratimin e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e Datës 20.12.2024, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër “**Mbi miratimin e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025**”, bazuar në: pikën 5 të nenit 72, neni 77,78 i Ligjit Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, germën “c” të nenit 9 të Ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe pagës minimale në shkallë vendi”, VKM-në Nr.328 Datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr. /2024 “Për buxhetin e vitit 2025” bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativimit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe pas diskutimit nga anëtarët e keshillit, u kalua në procesin e votimit ku u **miratua** me **17 Vota Pro, 0 Vota Kundër dhe 0 Vota Abstenim;**

VENDOSI:

1. Të miratojë shpërblimin mujor të Anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për Vitin 2025, i cili do të jetë në masën 10% të pagës së Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër .
2. Burimi financiar do jenë transfertat e pakushtëzuar, sipas detajimit të Buxhetit të Vitit 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR



RELACION

“Mbi miratimin e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025”

Institucioni i Këshillit të Qarkut Shkodër paraqet për shqyrtim, diskutim dhe miratim Përqindjen e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025.

Duke u bazuar në përmbajtjen e Ligjin Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përkatësisht në pikën 5 të nenit 72, ku thuhet se “anëtarët e këshillit të qarkut kryejnë funksione pa shpërblim, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur anëtarë të kryesisë së këshillit të qarkut”, neni 78, germën “c” të nenit 9 të Ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe pagës minimale në shkallë vendi”, sipas të cilit “shpërblimi mujor deri në masën 10% të pagës mujore të kryetarit të këshillit të qarkut”, VKM-në Nr.328 Datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr.503, date 01.08.2024, paraqesim për miratim përqindjen e Shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025.

Për vitin 2025, Institucioni i Këshillit të Qarkut Shkodër propozon për të miratuar masën e shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodëri cili të jetë 10% e pagës së Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe çdo ndryshim page i kryetarit do të reflektohet edhe në ndryshimin e pages se anetareve të kryesisë.

Presim miratimin tuaj për këtë Projekt-Vendim.

Nëpunësi Zbatues

Gjyljana MIRUKU

